



Raporti i Transparencës

i shoqërisë TPA Albania Sh.p.k

mbështetur ne nenin 45 te Ligjit 10 091 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin E profesionit të Audituesit Ligjor dhe Të Kontabilistit Të Miratuar

31 Mars 2019

TPA Albania Shpk

Rr.Reshit Çollaku, Pall. Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Shqipëri
www.tpa-group.com

Albania | Bulgaria | Croatia | Montenegro | Austria | Poland Rumania | Serbia | Slovakia | Slovenia | Czech Republic | Hungary

Përmbajtja

1.	Hyrje	3
2.	Përshkrimi i strukturës ligjore dhe i pronësisë te shoqërisë	3
3.	Përshkrimi i rrjetit ku shoqëria bën pjese	4
4.	Struktura drejtuese të shoqërisë së auditimit	4
5.	Sistemet e kontrollit të brendshëm të cilësisë.....	5
6.	Informacioni për kryerjen e kontrollit të fundit të cilësisë.....	6
7.	Lista e njësive ekonomike me interes publik te audituara	6
8.	Deklaratat e praktikave të pavarësisë	6
9.	Deklarata për politikën e ndjekur nga shoqëria audituese, për kualifikimin e vijueshëm profesional të audituesve ligjorë	7
10.	Informacioni financiar për vitin 2019.....	8
11.	Informacion në lidhje me bazat për shpërblimin e ortakëve të angazhimit	9

1. Hyrje

Në përputhje me nenin 45 të Ligjit 10 091 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar” të ndryshuar me Ligjin 47/2016 date 28 Prill 2016, audituesi ligjor ose shoqëria audituese, që kryen auditimin ligjor të njësive ekonomike me interes publik, brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar, publikon në faqen zyrtare të internetit një raport për transparencën.

Raporti i transparencës i referohet kompanisë së auditimit TPA Albania dhe përmbledh misionet e shoqërisë për vitin financiar të mbyllur me 31 Dhjetor 2019.


2. Përshkrimi i strukturës ligjore dhe i pronësisë të shoqërisë

Shoqëria është një person juridik shqiptar, dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji Tregtar”)

TPA Albania Shpk është regjistruar Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) më datën 19 Prill 2013 me seli në Rr. “Reshit Çollaku”, Pallati Shallvare, Sh.4, Apt.44, Tirane, Shqipëri dhe në Regjistrin publik të shoqërive të auditimit pranë Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar (IEKA) me numër 381 date 28.03.2014.

Struktura e Ortakeve të shoqërisë :

Kapitali i shoqërisë TPA Albania është i ndare në kuota. Ortaket e shoqërisë dhe përqindja respektive në kapital jepet si më poshtë :



3. Përshkrimi i rrjetit ku shoqëria bën pjese

TPA Albania bën pjese ne rrjetin TPA Group.

TPA Group

Grupi TPA është një nga shoqëritë kryesore të këshillimit dhe auditimit të taksave në Austri, si dhe në Evropën Qendrore dhe Juglindore me një ekip prej 650 punonjësish në 14 zyra në Austri.

Përveç zyrave në Austri, Grupi i TPA ka zyra në njëmbëdhjete vende te Evropës Juglindore (Shqipëri, Bullgari, Kroaci, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni, Republika Çeke, Hungari dhe Mali i Zi). I gjithë grupi numëron 1'700 punonjës me 30 zyra ne 12 vende.



Falë partneritetit të aleancës me rrjetin Baker Tilly International, të 12 vendet e Grupit TPA janë të pozicionuar me mire ne shkalle mbare botërore dhe mund të ofrojnë shërbime me cilësi të lartë në të gjitha qytetet dhe rajonet ekonomikisht të rëndësishme.

Rrjeti Baker Tilly International përbëhet nga më shumë se 120 anëtarë të pavarur në 145 vende me gjithsej 35,000 punonjës dhe 746 zyra duke qene rrjeti I dhjete më i madh i këshillimit dhe auditimit në të gjithë botën (burimi: Buletini i Kontabilitetit Ndërkombëtar).

Baker Tilly International është me seli në Londër dhe është në pronësi të shoqërive anëtare, me të gjithë aksionarët që mbajnë të njëjtën pjesë të kapitalit. Baker Tilly International në vetvete nuk ofron ndonjë shërbim në emrin e tij ose të dikujt tjetër. Të gjitha kompanitë anëtare janë të pavarura nga njëra-tjetra nga pikëpamja ekonomike, ligjore dhe operacioneve.

4. Struktura drejtuese të shoqërisë së auditimit

Shoqëria drejtohet nga Këshilli i Administrimit i përberë nga dy Ortake (“Partnere”) te cilët janë përgjegjës për aktivitetet e përditshme te Shoqërisë, te kufizuar ne kompetencat e tyre nga Statuti i Shoqërisë dhe ligji për shoqëritë Tregtare.


Administratoret e te Shoqërisë janë:

- 1) Z. Ilir Binaj- Ekspert Kontabel i Regjistruar
- 2) Znj. Laura Gjinali- Ekspert Kontabel i Regjistruar

5. Sistemet e kontrollit të brendshëm të cilësisë

TPA Albania zbaton standardet të larta profesionale në të gjitha shërbimet që jep për të ruajtur integritetin dhe reputacionin e saj por edhe të rrejtit ku bën pjesë. Në dhënien e shërbimeve të auditimit dhe të shërbimeve të tjera të dhënies së sigurisë dhe të rishikimit, Shoqëria vepron në përputhje të plote me Kodin e Etikës të IEKA dhe të Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionalë dhe Standardeve Ndërkombëtare të Pavarësisë të hartuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) përmes Bordit Ndërkombëtar të Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA).

Anëtarët e grupit TPA duhet të zbatojnë standardin ndërkombëtar të kontrollit të cilësisë të IFAC (SNKC1). Kjo kërkon që secili anëtar të zhvillojë një sistem të kontrolleve të brendshme të cilësisë për të siguruar që anëtari dhe stafi të respektojnë standardet dhe kërkesat rregullatore dhe ligjore dhe që raportet e lëshuara nga anëtari ose ortakët i angazhimit të jenë të përshtatshme për rrethanat.



Kontrulli i cilësisë në nivel angazhimi individual garantohet nga zbatimi prej audituesve ose ortakëve të angazhimit të gjithë kërkesave të përshkruara në të gjithë standardet ndërkombëtare të auditimit, të cilat janë të zbatueshëm në kontekstin e angazhimit individual. Kontrulli i cilësisë brenda firmës/kabinetit të auditimit, garantohet përmes vendosjes së rregullave të brendshme të rishikimit për qëllime të kontrollit të cilësisë së angazhimeve, të cilat bazohen në SNKC1 dhe në udhëzimet përkatëse të përpunuara nga IEKA.

Rishikimet e sigurimit të cilësisë kryhen jo vetëm nga institucionet përkatëse në Shqipëri (IEKA) por edhe nga vete grupi TPA i cili aplikon rishikime periodike të sigurimit të cilësisë për të gjithë anëtarët së paku një herë në tre vjet.

Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë i implementuar nga TPA Albania ka për qëllim të sigurojë që shërbimet e dhëna të jenë në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator të profesionit të audituesit në Shqipëri dhe standardet ndërkombëtare të zbatueshme.

Sistemi i sigurimit të cilësisë së TPA Albania përfshin :

- kuadrin rregullativ për pajtueshmërinë me parimet e përgjithshme profesionale dhe kodet profesionale
- Pranimin, vazhdimin dhe përfundimin e parakohshëm të angazhimeve ndaj klientëve
- Planifikim i përgjithshëm i të gjitha angazhimeve
- Rregulla të veçanta për rotacionin e brendshëm

- mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve të auditimit në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi dhe SNA
- Kryerjen e rishikimeve të brendshme për çdo shërbim të kryer ndaj klientit
- Zhvillimin e vazhdueshëm të punonjësve

6. Informacioni për kryerjen e kontrollit të fundit të cilësisë

Kontrolli i Cilësisë që organizohet nga IEKA është një procedurë e shqyrtimit nga Këshilli Drejtues i saj, në lidhje me veprimtarinë profesionale të një eksperti kontabël person fizik dhe të ortakëve e shoqërive (firmave) të auditimit vendase dhe të huaja. Këshilli Drejtues realizon kontrollin e cilësisë bazuar në Ligjin e Auditimit, Statutin e IEKAs dhe në pajtim me kërkesa të tjera të shpjeguara në Standardin Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1, dhe në Standardet Ndërkombëtare të kryerjes së Angazhimeve.

TPA i nënshtrohet rishikimeve periodike të organizuara nga IEKA Rishikimi për sigurimin e cilësisë. Raporti i fundit i rishikimit është kryer me 22 nëntor 2016 në nivel shoqëria (kabineti) dhe në nivel angazhimi. Opinioni në raport konfirmon se *sistemi i kontrollit të cilësisë për praktikën e kontabilitetit dhe auditimit të shoqërisë TPA Albania janë ndërtuar në mënyrë të përshtatshme dhe është zbatuar siç duhet duke dhënë shoqërisë së auditimit sigurinë e arsyeshme për kryerjen dhe raportimin e shërbimeve të auditimit dhe dhënies së sigurisë në përputhje me standarde profesionale të zbatueshme sipas llojit të shërbimit e të gjitha aspektet materiale.*

7. Lista e njësive ekonomike me interes publik të audituara

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

Emri	Aktiviteti	Për vitin e mbyllur më
SHKK UniFin	Institucion financiar jo-bankë	31 dhjetor 2017

Klasifikimi i njësive me interes publik është bërë në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm me 31 dhjetor 2017.

Sipas nenit 2 pika 23 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

"Njësi ekonomike me interes publik" janë:

- të gjitha njësitë ekonomike të listuara në bursë; b) bankat dhe degët e bankave të huaja, si dhe subjektet e tjera financiare jobanka, të licencuara nga Banka e Shqipërisë;
- shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit, shoqëritë administruese të fondeve të investimeve kolektive, shoqëritë administruese të fondeve të pensionit vullnetar;
- shoqëritë e tjera shtetërore ose private, të cilat janë të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Deklarata e praktikave të pavarësisë

Edhe pse TPA Albania është pjese e një rrjeti, i takon secilit anëtar të përcaktojë pozicionin e tyre midis kodit të etikës së aplikueshëm në vendet përkatëse.

Si rregull, rrjeti i TPA group përcakton se çdo anëtar i përmbahet kodit lokal të etikës. Nëse nuk ka një kod lokal ose nëse kodi vendor është dukshëm më pak i gjerë se Kodi i Etikës i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC) për llogaritarët profesionistë (Kodi), anëtarët pritet të respektojnë kodin e IFAC.

TPA Albania, ashtu si edhe anëtarëve të rrjetit ku ajo bën pjese, u kërkohet të përfshijnë një procedure në procesin e auditimit që duhet të konsiderojë nëse ka kërcënime të pavarësisë që vijnë nga kryerja e shërbimeve ndaj një klienti apo filialeve të tij. Kjo përfshin diskutime dhe komunikime me klientin lidhur me rrethanat në të cilat kërcënimi i pavarësisë mund të ndodhe.

Rrjeti ku shoqëria bën pjese ofron një bazë të dhënash për të gjithë anëtarët e saj e cila u lejon të zbatojnë kërkesat për pavarësi. Te gjithë anëtarët kanë detyrim të japin informacione në mënyrë që të mbahet një bazë të dhënash pavarësie sa më e përditësuar e cila i shërben :

shoqërive anëtarë të rrjetit të kryejnë kontrole të konflikteve të mundshme gjatë procesit të zbatimit të procedurave të brendshme për pranimin e klientit

Baker Tilly International dhe TPA Group të identifikojë të gjithë klientët e auditimit që duhen përfshirë në Listën e Entiteteve të kufizuara

Baza e të dhënave të pavarësisë përmban detaje të të gjithë klientëve që janë pjese e një grupi të listuar në tregjet e kapitalit, për të cilat secili anëtar jep shërbime shoqërive brenda grupit të listuar.

Te dhënat regjistrohen për të gjitha rastet kur anëtarët e rrjetit japin shërbime të lidhura me auditimin për shoqëritë e listuara. Ky informacion përdoret me tej për të krijuar Listën e Entiteteve të kufizuara, e cila tregon të gjithë klientët e listuar ku firmat anëtare të rrjetit janë auditues. Shoqëritë anëtare të rrjetit nuk duhet të kenë interesa financiar (si për shembull investime) në një shoqëri të përfshirë në Listën e Entiteteve të Kufizuara.

Një nga detyrat kryesore profesionale të audituesit është që ai të kryejë punën e tij në mënyrë të pavarur dhe pa rrethana që shkaktojnë kërcënim të pavarësisë.

Për këtë qëllim, të gjithë punonjësve të TPA Albania Shpk GmbH u kërkohet në bazë të një liste aktuale të klientëve të deklarojnë nëse ka ndonjë arsye për përjashtim të tyre nga një angazhim i caktuar .

9. Kualifikimi i vijueshëm profesional të audituesve ligjorë

TPA Albania inkurajon kualifikimin e vazhdueshëm si një mjet të rëndësishëm për zhvillimin e njohurive dhe ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të saj si dhe për motivimin dhe ruajtjen e personelit të saj.

Për ortaket e auditimit dhe stafin profesional, shoqëria u kërkon që të marrin pjesë në programet e duhura të zhvillimit profesional dhe monitorojnë përmbushjen e detyrimeve të programit.

Programi i arsimit të vazhdueshëm përbëhet nga seanca trajnimi të organizuara nga vete shoqëria, nga rrjeti ku ajo bën pjese si dhe trajnime të jashtme nga organet përkatëse profesionale ose organizata të tjera trajnimi që janë të akredituara nga IEKA. Disa kurse janë të detyrueshme dhe të tjera janë vullnetare. Kërkesat e kualifikimit për auditorët profesionistë në Shqipëri janë faktuar edhe në programin e IEKA.

10. Informacioni financiar për vitin 2018

Shënime shpjeguese në përputhje me nenin 45 të ligjit nr. 10091, datë 5 mars 2009 i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, datë 28 prill 2016 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar".

Ndarja e të ardhurave vjetore të TPA Albania për 2018:

	31 Dhjetor 2018	31 Dhjetor 2017
Shërbime kontabiliteti dhe takse	8,776,538	8,996,590
Auditim ligjor	10,626,647	9,658,326
Shërbime këshillimi financiar	549,900	189,952
Totali	19,953,085	18,844,868

11. Informacion në lidhje me bazat për shpërblimin e ortakëve të angazhimit

Sistemi i shpërblimit të ortakëve të TPA Albania është i bazuar në paga fikse mujore të cilat vendosen në përputhje me eksperiencën, vjetërsinë në shoqëri, kualifikimeve etj. Si ortakë të shoqërisë, ata marrin pjesë edhe në fitimet vjetore të saj.

TPA Albania Shpk

